

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-22-14609-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	NIKA PrO- Ing SH.P.K.
NUI	811052307
Adresa	Rr.Rexhep Bislimi
Vendi	Ferizaj
Kodi postar	70000
Numri Telefonit	044/249864
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	SHPEND MUSA
Adresa elektronike	nikaproing@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	15.05.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re

04.01.23 – Pershkrimi i cmimit

05.01.23 – B05 Njoftim per Kontrat

13.01.23 – Kerkese per Sqarime DT

20.01.23 – Dosja e Tenderit-Rikonstruimi i kulmit të Komunes.

03.02.23 – Kerkese per Sqarime DT 2

14.02.23 – B12 Procesverbali i hapjes se tenderve

20.04.23 – B58 Njoftim mbi vendimin e AK

04.05.23 – Vendim per rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Sipas procesit të hapjes së tenderëve renditja sipas çmimit me të lire është kështu:

1) "NBT -ING" SH.P.K	386,096.29
2) MBB Construction SH.P.K.; & EdiBau- ing SH.P.K	418,986.34
3) ENGINEERING RK SH.P.K.; & NIKA PrO- Ing SH.P.K.	501,501.00
...	
...	

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Per 8 pretendime tona, AK ka refuzuar duke e vlerësuar CDO PIKE të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi, dhe Krashasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënie të Kontratës

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 20.04.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e kanë rekomanduar për kontratë "NBT -ING" SH.P.K., ndërsa neve na keni eliminuar me arsyetimin se kushtet teknike të plotësimit por çmimi është me i shtrejtë.

Ne kërkesë për qasje në dokumentacion me datën 24.04.2023, AK-ja na kanë dhënë mundësi për qasje menjehere me datën 24.04.2023 dhe ne qasjen e dokumentacionit të këtij tenderi kemi vërejtun se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson Kërkesat e kërkuar në dosjen e tenderit.

Sa i përket vendimit të AK-se për Njoftim për dhanje të kontratës "NBT -ING" SH.P.K., ne kemi njoftuar AK përmes një **Kërkesë për rishqyrtim** me datën 25.04.2023 se "NBT -ING" SH.P.K. i rekomanduar për kontratë, **NUK është i përgjegjshëm.**

Poashtu edhe OE me radhe që vie me çmimin me të ulët, pas "NBT -ING" SH.P.K., pra **MBB Construction SH.P.K.; & EdiBau- ing SH.P.K. poashtu NUK është i përgjegjshëm.**

Po i sqarojmë pikat në cilat ne kemi dëshmuar që OE të lartëcekur nuk janë të përgjegjshëm, e që Autoriteti Kontraktues i ka mohuar të gjitha dhe ka cilesuar si të pa bazuar "Kërkesen tonë për Ri-shqyrtim".

Pika 1. Në kërkesën e FDT është kërkuar që:

OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon

1. Një inxhinier të Arkitektures ose Ndertimitaris (konstruktiv), min 5 vite përvojë pune pas diplomimit,

[menaxher i projektit.](#)

2. Nje Inxhinier ose Bachelor te [ndertimtaris Konstruktive](#), min 3 vite pervoje pune pas diplomimit

"NBT -ING" SH.P.K. ka ne list te stafit vetem nje Inxhinier te ndertimtarise z. Bexhet Baftjaraj, dhe nje Arkitekt z. Nexhat Bytyqin. VENDIM per menaxher e ka deklaruar Inxhinier te ndertimtarise z. Bexhet Baftjaraj.

Kjo nenkupton qe e ka plotesuar inxhinierin e pare te kerkuar, pasi qe eshte kerkuar te jete 1. Nje inxhinier te [Arkitektures ose Ndertimtaris \(konstruktiv\)](#), por nenkupton qe 2. Nje Inxhinier ose Bachelor te [ndertimtaris Konstruktive](#)

Erkuar nuk po e ploteson si kriter, sepse nuk ka 2 Inxhinier te ndertimtarise – Konstruktiv, por ka ofruar Arkitekt te pika numer 2. Sikur vendimi per menaxher te kishe qene per Arkitektin z. Nexhat Bytyqin, atehere do te ishte plotesuar kerkesa 1 dhe 2 per inxhinieret, por ky OE ka bere vendim per caktimin e menaxherit inxhinierin e ndertimtarise z. Bexhet Baftjaraj.

Kete kriter nuk e ka plotesuar OE dhe eshte i papergjegjshem.

Pika 2. Ne kerkesen e FDT eshte kerkuar qe:

[Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike per kryejen e puneve. Paisjet dhe mekanizimin OE duhet ta prezentoj ne **Aneksin 7** te DT.](#)

"NBT -ING" SH.P.K. ka plotesuar Aneks 7 sipas dosjes se tenderit. Kete kriter nuk e ka plotesuar OE dhe eshte i papergjegjshem.

Pika 3.

Ne cmimin e ofruar OE **MBB Construction SH.P.K.; & EdiBau- ing SH.P.K.** eshte i papergjegjshem ne baze te RROUP dhe rregullores se LPP-se pasi qe eshte me cmim te ulet jo normalishte, i cili e ploteson kushtin e mesatere qe eshte 30% me lire se OE tjere dhe e ploteson kushtin qe eshte me lire se 10% qe rendite i dyti.

Pika 4. Ne kerkesen e FDT eshte kerkuar qe:

Shuma e sigurimit te tenderit eshte valide ne periudhe prej 120 ditesh, nga data e ofertimit apo hapjes se tendereve.

Ndersa OE "NBT -ING" SH.P.K. sigurimin e tenderit e ka nga data 13.02.2023 – 13.06.2023, dmth nje dite para dates se ofertimit, sepse dorezimi i tenderit ka qene me daten 14.02.2023, e nese sigurimi i tenderit fillon nje dite perpara at'here i bie qe edhe te perfundoj nje dite perpara.

Kete kriter nuk e ka plotesuar OE dhe eshte i papergjegjshem

Pika 5. Ne kerkesen e FDT eshte kerkuar qe:

OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon

1. Nje inxhinier te [Arkitektures ose Ndertimtaris \(konstruktiv\)](#), min 5 vite pervoje pune pas diplomimit, menaxher i projektit.

Deshmija: 2.Vendimi per caktimin e menaxherit (menaxheri I projektit)

- Kopjet e Diplomave, te noterizuara (noterizimi te mos jete me i vjeter se 60 dite nga data e njoftimit per kontrate)

- CV të dokumentuara me REFERENCA qe dëshmojnë përvojën me se paku tre

vite,

-Kontrata për marrëdhënie pune, ose marrëveshje për angazhim për këtë projekt.

MBB Construction SH.P.K.; & EdiBau- ing SH.P.K. me inxhinierin e deklaruar te arkitektures z. Lumidin Asllani, nuk ka kontrate active, sepse kontrata e prezantuar eshte nga data 01.03.2022 – 01.03.2023, si dhe poashtu verehet qe ka falcifikuar nenshkrimin e inxhinierit, si dhe ne .PDF e prezantuar madje mund te klikohet ‘’filli’’ mbi te, qe ka vendosur siper, ndersa AK as nuk e ka verenjur fare, si dhe edhe pse ne ja kemi prezantuar ne ‘’kerkesen tone per rishqyrtim’’, na ka ka cilesuar si te pa bazuar .!!! Kete kriter nuk e ka plotesuar OE dhe eshte i papergjegjshem

Pika 6. Ne kerkesen e FDT eshte kerkuar qe:

Nje Inxhinier ose Bachelor te ndertimtaris Konstruktive, min 3 vite pervoje pune pas diplomimit.

Deshmija:

- Kopjet e Diplomave, te noterizuara (noterizimi te mos jete me i vjeter se 60 dite nga data e njoftimit per kontrate)

- CV të dokumentuara me REFERENCA qe dëshmojnë përvojën me se paku tre vite,

-Kontrata për marrëdhënie pune, ose marrëveshje për angazhim për këtë projekt.

MBB Construction SH.P.K.; & EdiBau- ing SH.P.K. me inxhinierin e deklaruar te ndertimtarise - Konstruktiv z. Karafidin Kuka, nuk ka kontrate active, sepse kontrata e prezantuar eshte nga data 01.03.2022 – 01.03.2023.

Kete kriter nuk e ka plotesuar OE dhe eshte i papergjegjshem

Pika 7. Ne kerkesen e FDT eshte kerkuar qe:

- Nje Inxhinier ose Bachelor te ndertimtaris Hidro, min 3 vite pervoje pune pas diplomimit.

Deshmija:

- Kopjet e Diplomave, te noterizuara (noterizimi te mos jete me i vjeter se 60 dite nga data e njoftimit per kontrate)

- CV të dokumentuara me REFERENCA qe dëshmojnë përvojën me se paku tre vite,

-Kontrata për marrëdhënie pune, ose marrëveshje për angazhim për këtë projekt.

MBB Construction SH.P.K.; & EdiBau- ing SH.P.K. me inxhinierin e deklaruar te ndertimtarise - Hidroteknik z. Kushtrim bajrami, nuk ka kontrate FARE

Pika 8. Ne kerkesen e FDT eshte kerkuar qe:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit , se bashku në të tri vitet ka qenë në vlerë prej jo më pak se 1.000.000,00 euro (60% Bartësi i konzorciumit).

"NBT -ING" SH.P.K. ka bere kerkese per konfidencialitet, te cilin dyshojme ne te

Siq shihet AK ka rekomanduar OE te papergjegjshem per kontrate, duke REFUZUAR kerkesen tone per rishqyrtim sit e pa bazuar.

Gjithashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i AK është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Në fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për Ankesa e grupit të OE **ENGINEERING RK SH.P.K.; & NIKA Pro-Ing SH.P.K.**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhe lënda kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

5,000.00

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*